INPO
Initiative for progress

RAPORT I MONITORIMIT
KOMUNA E FERIZAJT
JANAR – QERSHOR 2013

FERIZAJ, KORRIK 2013

Copyright © 2013, Iniciativa për Progres – INPO

INPO ka të gjitha të drejtat e rezervuara për këtë botim. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet apo shpërndahet në çfarëdo forme të mundshme pa lejen paraprake me shkrim të botuesit.

Qëndrimet e shprehura në këtë botim janë përgjegjësi vetëm e botuesit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen se përfaqësojnë qëndrimet e donatorit të këtij botimi.

PËRMBAJTJA

I. HYRJE
II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
III. METODOLOGJIA
IV. KUVENDI KOMUNAL
- PARTITË POLITIKE NË KK
- VENDIMET MË TË RËNDËSISHME
- AKTIVITETI I KËSHILLTARËVE KOMUNAL
- FUNKSIONIMI I KPF-SË

V. EKZEKUTIVI I KOMUNËS
- PREMTIMET E KRYETARIT
- DREJTORITË KOMUNALE
- ZYRA E PROKURIMIT

VI. ADMINISTRATA KOMUNALE
VII. RESPEKTIMI I PARIMEVE TË QEVERISJES SË MIRË
- TRANSPARENCA
- DEBATET PUBLIKE
- PJESËMARRJA E QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE
- PETICIONI

VIII. REKOMANDIME
IX. PËR INPO.

I. HYRJE

Raporti që keni në dorë ka për qëllim që të prezantoj monitorimin e punës dhe aktiviteteve të komunës së Ferizajt, për periudhën Janar-Qershor 2013. Shtytja për përpilimin e këtij raporti rrjedh nga përpjekjet e INPO-s që për vite me radh të kontribuoj në fuqizimin e parimeve të qeverisjes së mirë, siç është transparenca dhe llogaridhënia në nivelin lokal.

Raporti është i ndarë në tri pjesë kryesore;

Në pjesën e parë kemi paraqitur rolin e kuvendit komunal, pasivitetin e këshilltarëve komunal dhe komoditeti që po i krijohet kryetarit Aliu nga mungesa e kontrollit prej kuvendit komunal.

Në pjesën e dytë, janë paraqitur aktivitetet e ekzekutivit, duke filluar me mos-realizimin e premtimeve elektorale nga kryetari Aliu, mungesën e planeve strategjike dhe mos-respektimin e udhëzimeve administrative dhe legjislacionit mbi qeverisjen lokale. Në aktivitetet e ekzekutivit është paraqitur edhe puna e disa drejtorive komunale, të cilat gjatë kësaj periudhe të raportimit nuk kanë qenë transparente dhe kanë mungesë të kapaciteteve.

Drejtoria e Administratës është shquar gjatë kësaj periudhe për shkelje procedurale, siq ka qenë rasti me mos-procedimin e peticionit të fshatit Prelez. Zyra e prokurimit gjatë këtij gjashtë mujori ka qenë e mbyllur dhe nuk i ka lejuar INPO-s qasje në të gjitha fazat e prokurimit, me arsyetimin se kjo nuk lejohet me Ligjin për Prokurimin Publik. Një kapitull i veçantë i është kushtuar administratës komunale e cila është e stërngarkuar me punëtor, nën ndikimin e politikës dhe të nepotizmit.

Në pjesën e fundit të raportit, është paraqitur respektimi i parimeve të qeverisjes së mirë nga komuna e Ferizajt dhe rekomandimet e INPO-s të dala nga procesi i monitorimit.

II. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Raporti i monitorimit komuna e Ferizajt Janar-Qershor pasqyron gjetjet kryesore, analizat dhe rekomandimet e dala nga procesi i monitorimit të punës së komunës së Ferizajt. Gjatë kësaj periudhe janë monitoruar nga afër të gjitha segmentet e punës së administratës komunale duke filluar që nga realizimi i premtimeve nga kryetari, puna e drejtorive komunale, puna e kuvendit komunal dhe komiteteve të tij deri tek puna e ndërmarrjeve publike.

Nga procesi i monitorimit të vazhdueshëm mund të konkludojmë se për këtë periudhë gjashtë mujore kuvendi komunal i Ferizajt ka qenë pasiv, nuk i ka ushtruar kompetencat e veta dhe nuk e ka realizuar misionin e tij si organi më i lartë i komunës. Me fjalë të tjera Kuvendi nuk ka ndërmarrë asnjë iniciativë shtesë për të komunikuar me qytetarët apo për të kërkuar më shumë përgjegjësi nga ekzekutivi për funksionimin e ndërmarrjeve publike, menaxhimin e buxhetit dhe vonesat në implementimin e projekteve.

Roli i kuvendit komunal është reduktuar vetëm në procesin e votimit të propozim-vendimeve që vijnë nga ekzekutivi i komunës, pra në ngritjen e duarve nga këshilltarët komunal për votim. Kuvendi komunal i Ferizajt nuk ka shënuar ndonjë ngritje sa i përket cilësisë së pjesmarrësve në mbledhje duke aprovuar pikat e rendit të ditës ashtu siç vijnë nga Komiteti për Politikë dhe Financa(KPF).

Sa i përket aktivitetit të këshilltarëve në këtë komunë, nga monitorimi i seancave të kuvendit për debate konstruktive më shumë kanë qenë aktivë, Faruk Guri dhe Sahit Krasniqi nga LDK-ja, Rafiz Sejdiu nga PDK-ja dhe Kemajl Ramdani nga AAK-ja.

INPO ka vërejtur se gjatë kësaj periudhe të raportimit KPF-ja nuk ka arritur që t'i kryej funksionet e veta ashtu siq parashihet me nenin 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

Kryetari Aliu ka vazhduar të qeverisë komunën e Ferizajt duke bërë shkelje të nenit 57 të Statutit të komunës duke mos i emëruar apo shkarkuar drejtorët e drejtorive komunale të zgjedhur për mandatin e z.Bajrush Xhemailit.

Gjatë këtij mandati qeverisës z.Aliu nuk e ka prezantuar as planin vjetor të punës apo ndonjë platform tjetër të qeverisjes, por ka vazhduar të mbështetet në ato qka ishin lënë dhe planifikuar nga pararënëdësi i tij z.Xhemaili. Për më tepër kryetari nuk i ka respektuar as Udhëzimet Administrative të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si me rastin e mos hartimit të planit e transparencës.

Komuna e Ferizajt është dëshmuar për mungesë të vizionit dhe gjatë kësaj periudhe është qeverisur vetëm me objektiva afatshkurtëra që konsistojnë në investime kapitale

infrastrukturore, ose me fjalë tjera në asfaltim të rrugëve dhe që nuk premtojn zgjidhjen e problemeve dhe mirëqenie për qytetarin ferizajas.

Duke pasur parasysh mungesën e disa prej dokumenteve bazike, si strategjia për zhvillim ekonomik lokal, plani vjetor i qeverisë komunale dhe plani i transparencës, mund të konkludojmë se gjatë kësaj periudhe të raportimit qeverisja e kryetarit Aliu nuk i ka realizuar premtimet elektorale, nuk i ka përmbushur shumë obligime që dalin nga legjislacioni në fuqi dhe është kufizuar në shpërndarjen e informatave që ofrojn vetëm aspekte pozitive të komunës, dhe si e till ka qenë pjesërisht e suksesshme.

Për më tepër, INPO-ja vlerëson se mos-prezenca e kryetarit Aliu në mbledhjen ku është diskutuar për gjendjen financiare të komunës ka qenë mos-respektim i ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, i cili e përcakton kryetarin si palë raportuese në KK për ecurinë financiare të komunës.

Një problem tjetër që ka vërejtur INPO lidhur me transparencën në komunën e Ferizajt kanë qenë konkurset e sofistikuara për punësim në administratë dhe pranimin e personelit në baza partiake në kopshtin e fëmijëve në lagjen e re.

Të gjeturat e INPO-s edhe për funksionimin e shumicës së drejtorive komunale flasin për një mospërmbushje të detyrave. Zyra e Prokurimit gjatë këtij gjashtë mujori ka qenë e mbyllur për INPO-n. Kjo zyrënë nuk ka qenë e gatshme që ta pranoj prezencën e INPO-s në të gjitha fazat e prokurimit me arsyetimin se një gjë të till nuk e lejon Ligji për Prokurimin Publik. Drejtoria për ekonomi dhe financa nuk ka qenë transparente në paraqitjen e shpenzimeve të buxhetit të komunës në mënyrë të detajuar. Po ashtu, drejtoria e arsimit nuk ka qenë transparente gjatë procesit të përzgjedhjes së drejtorëve të shkollave të mesme dhe fillore në Ferizaj.

Drejtoria e planifikimit, zvhillimit dhe rindërtimit nuk ka qenë e suksesshme në përmbushjen e detyrave të veta. Planifikimi mbetet një prej fushave më të ndieshme në komunën e Ferizajt. Ekzekutivi ferizajas shquhet për veprime ad-hoc, të pa bazuara në dokumente strategjike dhe të pa koordinuara me objektivat për zhvillim ekonomik.

Gjatë këtij gjashtë mujori disa nga kërkesat e INPO-s nuk janë marrë parasysh, janë refuzuar pa arsye nga komuna duke kryer edhe shkelje të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, kurse edhe ato pak kërkesa në të cilat komuna është përgjigjur, kanë qenë të natyrës përshkruese dhe nuk e kanë ofruar informacionin e kërkuar. Për periudhën e raportimit INPO ka dorëzuar gjithësej 26 kërkesa në komunën e Ferizajt, prej tyre 23 kërkesa kanë qenë për qasje në dokumente publike, kurse 1 kërkesë ka qenë për ndryshimin e rregullores për ndarjen e bursave për studentë, dhe 1 kërkesë për qasje në komisionin vlerësues të tenderëve.

Prej këtyre kërkesave për qasje në dokumente publike vlen të përmendet se Drejtoria e Inspeksionit i ka refuzuar INPO-s pa ndonjë arsyetim qasjen në numrin e ndërtimeve pa leje dhe objekteve të padefinuara në zonat urbane 3 dhe 6 të Ferizajt.

Duke shprehur përcaktimin tonë që të punojmë një raport sa më objektiv dhe sa më analitik, shpresojmë që ky raport të mirëpritet dhe të pranohet si një vërejtje publike për t'i përmirësuar qasjen dhe përmbushjen e detyrave ligjore nga komuna e Ferizajt.

III. METODOLOGJIA

Në kuadër të programit për qeverisje të mirë dhe realizimin e objektivave të parapara me projektin për "Promovimin e transparencës dhe llogaridhënies në Kosovën Juglindore", INPO ka parashikuar një varg aktivitetesh për t'u implementuar. Këto aktivitete mund të përmblidhen në aktivitete për promovimin e transparencës, komunikimit dhe llogaridhënies së komunës ndaj qytetarëve dhe monitorimin e drejtpërdrejtë të punës së organeve komunale, ku përfshihen ekzekutivi, i cili udhëhiqet nga Kryetari i komunës dhe Asambleja Komunale dhe komitetet e saj.

Hartimi i këtij raporti është bërë duke përdorur metodën kuantitative, elemente të metodës kualitative dhe metodës krahasuese. Raporti bazohet në një analizë të thellë të Udhëzimeve Administrative, përfshirë këtu legjislacionin aktual që rregullon veprimtarinë e komunave, buxhetet vjetore dhe raportet e ndryshme financiare, projektet kapitale, statutin e komunës së Ferizajt, rregulloret që ka nxjerr kuvendi komunal i Ferizajt, intervistat me drejtorët e drejtorive të komunës dhe personelin në përgjithësi.

Për më tepër tashmë INPO ka zhvilluar edhe metodologjinë e vet të monitorimit të komunave, ku ka të angazhuar monitorues, detyra e të cilëve është që të monitorojnë aktivitetin dhe efikasitetin e punës së ekzekutivit të komunës dhe asamblesë komunale në kuadër të parimeve të qeverisjes së mirë. Kështu që të dhënat që janë mbledhur nga raportet e monitorimit shërbejnë si të dhëna primare për hartimin e këtij raporti.

Në bazë të metodologjisë së monitorimit, INPO monitoron këto aspekte të qeverisjes lokale në Ferizaj:

- Mbledhjet e Kuvendit Komunal dhe komiteteve të tij (KPF dhe KPK)
- Aktivitetet e ekzekutivit të komunës së Ferizajt
- Përfshirja e qytetarëve ne vendimmarrje

Periudha për të cilën raportohet përfshinë periudhën Janar - Qershor 2013

IV. KUVENDI KOMUNAL

Vetëqeverisja Lokale në Kosovë është materie kushtetuese dhe garanton aplikueshmërinë e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale. Në Kartën Evropiane thuhet se e drejta për vetëqeverisje lokale, me qëllim të menaxhimit të çështjeve publike në të mirë të qytetarëve, duhet të ushtrohet nga këshillat apo kuvendet të cilat nën mbikëqyrje mund të kenë organet ekzekutive që u raportojnë atyre.[1]

Në mbështetje të Kartës evropiane për vetëqeverisjen lokale funksionimi i kuvendit komunal, shikuar nga aspekti formal dhe juridik të krijon përshtypjen e një demokracie funksionale, me ndarje të pushteteve, ku ekzekutivi i komunës është llogaridhënës ndaj kuvendit komunal, i cili zgjedhet drejtëpërdrejtë nga qytetarët për një mandat katër vjeqar për të përfaqësuesuar interesin e publikut të gjërë në nivelin vendimmarrjes së institucioneve lokale. Konkretisht në bazë të nenit 35 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Kuvendi Komunal (KK) është organi më i lartë vendimmarrës i komunës, i cili zgjedhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet Lokale.[2]

Edhe pse baza ligjore për qeverisjen lokale e përkufizon kuvendin e komunës si organ mbikëqyrës dhe e ngarkon me përgjegjësi që të siguroj ofrimin e shërbimeve nga ekzekutivi i komunës në pajtim me ligjin[3], kjo nuk është duke u zbatuar në praktikë. ***Gjatë monitorimit sistematik që INPO i bënë komunës së Ferizajt, kemi vërejtur se roli i kuvendit komunal është reduktuar vetëm në procesin e votimit të propozim-vendimeve që vijnë nga ekzekutivi i komunës, pra në ngritjen e duarve nga këshilltarët komunal për votim.***

Në këtë këndvështrim, janë dy aspekte të rëndësishme të cilat INPO i konsideron si pengesa të konsolidimit të një qeverisje lokale demokratike. ***Në parim mund të thuhet se vakumi ligjor dhe mos-definimi i qartë i kompetencave e kanë lënë Kuvendin Komunal pa mekanizma të kontrollit dhe e kanë fuqizuar shumë kryetarin e komunës, duke e shëndrruar ekzekutivin në një trup dominues. Nga ana tjetër pasiviteti i këshilltarëve komunal dhe posedimi i shumicës së ulëseve nga partia që udhëheq me ekzekutivin e komunës e kanë akomoduar mjaftë mirë kryetarin e komunës, duke i pamundësuar kuvendit komunal ushtrimin edhe të atyre pak kompetencave dhe përparësive që i'u garantohen me ligj***.

Në proporcion me numrin e popullësisë, kuvendi komunal i Ferizajt përbëhet prej 41 (dyzet e një) anëtarëve. Siç mund të shihet nga tabela më poshtë Partia Demokratike e Kosovës(PDK)

[1] Shih nenin 3.2 të Kartë Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, e disponueshme në http://www.coe.int/t/dgap/localdemocracy/centre_expertise/tools/ToolkitI.pdf
[2] Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, neni 35, i disponueshëm në http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_al.pdf
[3] Manuali i Qeverisjes Lokale, fq. 26

mban numrin më të madh të ulseve në Kuvend me 16 delegat, pastaj Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK) me 11 delegat të ndjekura nga Aleanca për Kosovën e Re(AKR) dhe Aleanca për Ardhmërin e Kosovës(AAK) me nga 5 delegat. PDK në koalicion me Aleancën për Kosovën e Re formojnë kuorumin e nevojshëm (50%+1) për të miratuar vendimet në Kuvend.

Tabela 1. Shpërndarja e ulseve në KK të Ferizajt sipas Partive Politike

PDK	LDK	AKR	AAK	PD	PAI	I PAVARUR
16	11	5	5	1	1	1

Grafiku 1. Shpërndarja e ulseve në KK të Ferizajt sipas Partive Politike

Posedimi i shumicës së ulseve në KK të Ferizajt në njërën anë dhe pasiviteti i këshilltarëve komunal si dhe presioni që ushtrohet mbi ta në anën tjetër, i kanë mundësuar ekzekutivit ferizajas marrjen e shumë vendimeve të rëndësishme me karakter partiak, duke filluar me

emërimin e bordeve të drejtorëve të ndërmarrjeve publike në kundërshtim me kriteret e përcaktuara me ligjin për ndërmarrjet publike, tejkalimin e vlerës së projekteve të planifikuara me buxhetin e vitit 2012 pa autorizimin e Kuvendit Komunal, pranimin e personelit në baza partiake në kopshtin e fëmijëve në lagjen e re, përzgjedhjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile nëpër komisione të ndryshme të kuvendit komual në bazë të preferencave të partisë në pushtet si në rastin e formimit të komisionit për dhënie me qira të banesave në pronësi të komunës, pastaj edhe me emërimin e antarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

INPO ka vërejtur se bordet e drejtorëve në ndërmarrjet publike të Ferizajt janë të politizuara, pra nuk janë organe që mbajnë përgjegjësinë për udhëheqjen e institucioneve të pavarura dhe nuk janë transparente. Konkretisht, këto ndërmarrje nuk janë llogaridhënëse ndaj qytetarëve që i financojnë pasi që nuk prezantojnë raporte të detajuara financiare dhe nuk e bëjnë veprimtarinë e tyre transparente për qytetarët. Për më tepër bordet e ndërmarrjeve publike në Ferizaj ka gati 1 vitë që funksionojnë në kundërshtim me ligjin, pasi që drejtorëve të tyre atyre u ka skaduar mandati.

INPO e ka ngritur këtë problem në tryezën mbi ndërmarrjet publike[4] dhe ka kërkuar që kuvendi komunal të jetë më aktiv në kërkimin e përgjegjësive për punën dhe funksionimin e ndërmarrjeve publike dhe të mos e lejoj që kompetencatë e kuvendit t'i ushtrojë ekzekutivi i komunës.

Gjatë vitit 2013 ekzekutivi ferizajas tejakaloji vlerën e parashikuar të projeketeve të parapara me planin e punës për vitin 2013 në gjithësej 38 kontrata, pa miratimin e Kuvendit Komunal, që nënkupton se komuna e Ferizajt ka nënshkruar kontrata pa zotim të mjeteve dhe ka bërë shkelje procedurale. Mirëpo edhe ndaj këtyre veprimeve të paligjshme të ekzekutivit, Kuvendi Komunal nuk ka ndërmarr asnjë masë për të kërkuar përgjegjësi dhe për ta mbajtur ekzekutivin llogaridhënës për mos respektimin e kompetencave të KK.

Përkundrazi, përpjekjet e partisë që udhëheqë me komunën për të mos e respektuar parimin e ndarjes së pushteteve dhe për të dominuar kuvendin komunal në saje të ulseve që mban, u vërejtën më së miri gjatë kërkesës së grupit parlamentar të PDK-së për ta shkarkuar kryesuesin e Kuvendit Komunal z.Xhavit Zariqin, i cili kishte ndërruar orientimin politik nga Partia Demokratike e Kosovës në Aleancën për Ardhmërin e Kosovës.

Kjo mbledhje e rregullt e Kuvendit Komunal të Ferizajt në të cilën u kërkua shkarkimi i z.Zariqit, që u mbajt në mars të vitit 2013, ishte ndër mbledhjet e pakta ku opozita e braktisi sallën e Kuvendit dhe koalicioni PDK-AKR dështoi që ta shkarkoj nga pozita e kryesuesit z. Xhavit Zariqin.

[4] INPO organizon debat me komunën e Ferizajt mbi ndërmarrjet publike

Nga procesi i monitorimit të vazhdueshëm mund të konkludojmë se për këtë periudhë gjashtë mujore Kuvendi Komunal i Ferizajt ka qenë pasiv, nuk i ka ushtruar kompetencat e veta dhe nuk e ka realizuar misionin e tij si organi më i lartë i komunës. Me fjalë të tjera Kuvendi nuk ka ndërmarrë asnjë iniciativë shtesë për të komunikuar me qytetarët apo për të kërkuar më shumë përgjegjësi nga ekzekutivi për funksionimin e ndërmarrjeve publike, menaxhimin e buxhetit dhe vonesat në implementimin e projekteve.

Në vazhdim i kemi paraqitur emrat e këshilltarëve komunal dhe aktivitetin e tyre gjatë seancave të Kuvendit, të vlerësuara me pikë nga 1 deri në 5. Këtë vlersim INPO e ka bërë në bazë të propozimeve dhe diskutimeve që kanë bërë këshilltarët komunal gjatë seancave të Kuvendit. Shumica e këshilltarëve komunal janë vlerësuar më notën 1 duke pasur parasysh se gjatë këtyre gjashtë muajve këta këshilltarë nuk kanë dhënë asnjëherë propozime për rend të ditës, nuk kanë marrë pjesë në diskutime dhe nuk kanë dhënë asnjëheër rekomandime për zgjidhjen e çështjeve që janë ngritur në Kuvend. Ndërsa këshilltarët me vlerësimin më të lartë për aktivitetin e tyre janë Sahit Krasniqi, Kemajl Ramadani, Rafiz Sejdiu dhe Faruk Guri.

Mos angazhimi i këshilltarëve komunal ka bërë që Kuvendi Komunal i Ferizajt t'i kryej vetëm obligimet e ngushta për të cilat e detyron ligji, duke mos i shfrytëzuar edhe shumë nga përparësitë që i krijohen me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, siç është neni 58 pika j e cila e obligon kryetarin e komunës që të raportoj para kuvendit të komunës për situatën ekonomike-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj dhe kurdoherë që një gjë e till kërkohet nga kuvendi i komunës.[5] Kurse gjatë kësaj periudhe kuvendi komunal nuk e ka ftuar asnjëherë kryetarin e komunës për të raportuar për situatën ekonomike-financiare të komunës.

[5] Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, neni 58 pika j, i disponueshëm në http://ëëë.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_al.pdf

Tabela 2. Aktiviteti i Këshilltarëve Komunal gjatë seancave të Kuvendit

Vlerësimi nga 1 deri 5

Emri dhe Mbiemri	**1**	**2**	**3**	**4**	**5**
Ylber Topalli			**x**		
Lulzim Aliu	**x**				
Makfire Sadiku	**x**				
Xhevdet Sahiti	**x**				
Rafiz Sejdiu				**x**	
Ilir Orllati	**x**				
Ali Luzha	**x**				
Asllan Shabani	**x**				
Zymrije Haxhimusa	**x**				
Hajrie Nebihu		**x**			
Shpresa Azemi	**x**				
Avdullah Hoxha	**x**				
Valon Eshrefi	**x**				
Medain Hashani			**x**		
Mirlinda Bytyqi-Rexhepi	**x**				
Ramadan Hasani			**x**		
Flamur Fazlija	**x**				
Lulzim Grainca	**x**				

Arbenita Sadiku	x				
Burbuqe Bucaliu	x				
Sahit Krasniqi					x
Hesat Shatrolli	x				
Teuta Beqa	x				
Imri Hashani			x		
Ramadan Baliu		x			
Sahadete Lohaj	x				
Vjollca Ahmeti	x				
Ismajl Nazifi	x				
Adem Sejdiu	x				
Faruk Guri				x	
Miradije Goga	x				
Kemajl Ramadani					x
Fatmir Azizi			x		
Ferinaze Isufi	x				
Gazmend Bytyqi	x				
Tevide Imeri		x			
Hetem Ibrahimi		x			
Bekim Ademi			x		
Asllan Kryeziu			x		
Naser Emini	x				

Grafiku 2. Aktiviteti i Këshilltarëve Komunal gjatë seancave të Kuvendit, vlerësuar nga 1 deri 5

Funksionimi i KPF-së

Në mbështetje të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe në përputhje me rregulloren e punës, kuvendi i Ferizajt ka themeluar të gjitha komitetet obligative. Komitetet funksionale në kuvendin e Ferizajt janë Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) dhe Komiteti për Komunitete (KPK).

INPO ka vërejtur se gjatë kësaj periudhe të raportimit KPF-ja nuk ka arritur që t'i kryej funksionet e veta ashtu siq parashihet me nenin 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.[6] Fillimisht KPF-ja nuk është treguar efikase në mbikëqyrjen e performancës buxhetore vjetore, përndryshe do ta kishte ngritur në kuvend çështjen e tejkalimit të vlerës së projekteve të parapara me buxhetin e vitit 2012 dhe do të kishte apeluar në kuvendin komunal se administrimi i financave në komunën e Ferizajt nuk është në rrugën e duhur dhe se kjo përbën rrezik për organizatën buxhetore.

KPF nuk ka qenë aktive në monitorimin e punës së drejtorive komunale, caktimin e personelit për çdo drejtori komunale, nuk ka dorëzuar në kuvend ndonjë mendim këshilldhënës se si të menaxhohen ndërmarrjet publike komunale, dhe nuk e ka monitoruar zbatimin e rekomandimeve të Auditorit Gjeneral nga komuna e Ferizajt.

KPF-ja shpeshherë nuk i ka përfillur kërkesat e qytetarëve, siq ka ndodhur në mbledhjen e mbajtur me 08 Korrik 2013, ku pika 8 e rendit të ditës që ishte shqyrtimi i kërkesave nuk u morr parasysh nga anëtarët e komitetit, përderisa kërkesa e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale që i'u prezantua antarëve të KPF-së pak minuta para se të fillonte mbledhja zuri vend për t'u diskutuar në mbledhje. INPO është e shqetësuar për këtë qasje neglizhente të KPF-së dhe vlerëson se kjo është një politikë e papërgjegjshme, klasifikuese dhe nuk reflekton parimet e qeverisjes së mirë, ku institucionet janë llogaridhënëse dhe transparente ndaj kërkësave të qytetarëve.

Vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe të monitorimit administrata e kuvendit komunal shikuar nga këndvështrimi i KPF-së ka qenë jo funksionale. Ngatërrimi i kompetencave të zyrtares për informim të kuvendit komunal me zyrën e kryetarit dhe qasjen në dokumente publike kanë bërë që komunikimi me qytetarë dhe me palët e interesuara për punët e komunës të mos jetë në nivelin e duhur, të shkaktojë vonesa në dhënien e përgjigjieve, të ndikoj në mos-

[6] Ligji për Vetëqeverisjen Lokale në nenin 52 thekson se: Komiteti për politik dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në kuvendin e komunës.

procedimin e kërkesave të qytetarëve si dhe publikimin e njoftimeve lidhur me aktivitetin e komunës dhe KPF-së në veqanti.

Në këtë këndvështrim, duke pasur parasysh këto mangësi në punën e KK dhe KPF-së INPO e ka parë si shqetësuese edhe kandidaturën e kryesuesit të kuvendit komunal z.Xhavit Zariqit për kryetar komune nga radhët e AAK-së. INPO konsideron se angazhimi i z.Zariqit në fushatën zgjedhore mund të ndikojë në punën e tij si kryesues dhe të pengoj atë në ushtrimin e funksioneve të plota si kryesues i kuvendit.

Gjithashtu kryesuesi i kuvendit të komunës i cili njëherit është edhe kryesues i KPF-së nuk i është përgjigjur disa kërkesave të INPO-s, që disa çështje siq ka qenë ndryshimi i rregullores për ndarjen e bursave për student të diskutohet në KPF dhe pastaj të procedohet si pikë e rendit të ditës për mbledhjen e kuvendit të komunës.

Në mënyrë të rregullt INPO është njoftuar nga zyrtarja për informim dhe ka pranuar ftesën e kryesuesit të kuvendit për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, por jo edhe për mbledhjet e KPF-së, si trupi më i rëndësishëm politik i Kuvendit. Kjo mos-transparencë në punën e komiteteve të Kuvendit e ka penguar komunikimin mes palëve të interesuara dhe aktiviteteve të komunës si tërësi dhe e ka detyruar INPO-n që të marrë informacione për datën dhe kohën e mbledhjeve të KPF-së nga kanale të tjera.

INPO e ka adresuar disa herë çështjen e ndarjes së përgjegjësive mes zyrës për informim dhe ekzekutivit të komunës, por siç duket ekzekutivi ferizajas akoma nuk e ka gjetur zgjidhjen për shtimin e efikasitetit të punës së vet dhe ngritjen e nivelit të informimit publik për punën e komiteteve të kuvendit, që do të ndikonte edhe në ngritjen e transparencës së përgjithshme në komunën e Ferizajt.

Në fund, INPO vlerëson lartë nismën e kuvendit të komunës së Ferizajt, për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje përmes nenit 38 të statutit të komunës, ku është theksuar decidivisht se çdo pjesëmarrës në mbledhje të kuvendit dhe komiteteve të tij, me lejen e kryesuesit të mbledhjes, mund të bëjë pyetje dhe mund t'i drejtohet mbledhjes.[7] Kjo është një praktikë e mirë që i krijon mundësi qytetarëve që t'i paraqesin problemet e tyre, të drejtojnë pyetje apo kërkesa të drejtëpërdrejta përfaqësuesve të tyre. INPO në të ardhmen do të avokoj që një praktik e till të aplikohet edhe nëpër komuna të tjera të Kosovës.

[7] Për më tepër shih Statutin e komunës së Ferizajt, neni 38, i disponueshëm në http://kk.rks-gov.net/ferizaj/getattachment/Municipality/Assembly/Statute/STATUTI-I-KOMUNES.pdf.aspx (Qasur në Qershor 2013)

Vendimet e KK

Nga aktiviteti i kuvendit komunal që është paraqitur më lartë mund të konkludojmë se roli i kuvendit komunal është reduktuar në procesin e votimit të propozimeve që vijnë nga ekzekutivi. Në vazhdim kemi paraqitur vendimet më të rëndësishme të KK të Ferizajt për periudhën Janar-Qershor 2013. Pjesa më e madhe e vendimeve kanë kaluar pa debat të mirëfilltë në mesin e këshilltarëve komunal dhe në disa raste është vërjetur edhe mungesa e prezencës së drejtorëve komunal dhe kryetarit të komunës, si propozues të vendimeve dhe njëherit të obliguar që të jenë prezent që t'iu përgjigjen pyetjeve të këshilltarëve komunal dhe për dhënë sqarimet e nevojshme rreth propozimeve.

Gjatë marrjes së vendimeve antarët e kuvendit komunal kanë dëshmuar se interesat e qytetarëve dhe interesat e gjithmbarshme të komunës nuk janë parimi udhëheqës për vendimet e tyre. Gjatë periudhës Janar-Qershor 2013 kuvendi komunal i Ferizajt ka mbajtur gjithësej 7 (shtatë) mbledhje të rregullta dhe 1 (një) mbledhje të jashtëzakonshme.

Vendimet më të rëndësishme të KK për periudhën Janar-Qershor kanë qenë:

- Miratimi i rregullores për Barazi Gjinore
- Miratimi i ndryshimeve në Statutin e komunës në mbledhjen e rregullt të 28 Qershorit 2013, pas dështimit në mbledhjen e 29 Majit 2013 ku ndryshimet e propozuara nuk i morën votat e shumicës.
- Miratimi i kornizës afatmesme buxhetore 2014-2016.

Grafiku 3. Mbledhjet e planifikuara të Kuvendit Komunal për periudhën Janar-Qershor 2013

V. EKZEKUTIVI I KOMUNËS

'Qeverisja Komunale ekziston vetëm teorikisht, ne qeverisemi nga larg'. Tha Marvin Wiseth, pasi kishte qenë për disa vjet me radhë kryetar bashkie në Trondheim.[8]

Ekzekutivi i pushtetit lokal përbëhet nga dy organe, nga zyra e kryetarit të komunës dhe drejtorët e drejtorive komunale.

Kryetari Agim Aliu erdhi në krye të komunës së Ferizajt pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme gjatë vitit 2012, dhe vazhdoi qeverisjen e lënë përgjysmë nga z.Bajrush Xhemaili. Ai trashëgoi drejtorët e drejtorive komunale të emëruar nga z.Xhemaili dhe vazhdoi të udhëheq komunën duke bërë shkelje të statutit të komunës së Ferizajt, konkretisht nuk e respektoi asnjëher gjatë mandatit të tijë nenin 67.2 të Statutit që thekson se ''çdo drejtori komunale menaxhohet nga drejtori, i cili emërohet nga kryetari për të njëjtin mandat dhe shkarkohet nga kryetari''.[9]

Gjatë fushatës zgjedhore z.Aliu, ndonëse e kishte të qartë se po e vazhdonte një mandat qeverisës prej 1.5 vjet, kishte prezantuar para elektoratit një listë të gjatë premtimesh, me vetëm disa premtime më konkrete: projektin për funksionalizimin e bifurkacionit, ndërtimin e një stadiumi në qytetin e Ferizajt, krijimin e zonave ekonomike të qytetit si dhe krijimin e mundësive të reja për punësim.

Edhe pse kryetatri menjëherë pas marrjes së mandatit kishte deklaruar se premtimet nuk do t'i lë në aspektin formal por do t'i bëjë ato të prekshme dhe reale[10], për realizimin e këtyre premtimeve kryetari nuk ka prezantuar asnjëher ndonjë plan apo strategji konkrete se si planifikon që të realizoj ato qka i ka premtuar në fushatë dhe si rezultat i kësaj të gjitha premtimet e dhëna mund të themi se janë realizuar vetëm pjesërisht, kurse shumica e premtimeve as nuk kanë filluar që të realizohen.

[8] Kval,Mellbye,Tranoy(2006):Politika dhe Demokracia.Prishtinë,Rozafa,Botimi II, fq.92

[9] Shih statutin e komunës së Ferizajt, i disponueshëm në http://kk.rks-gov.net/ferizaj/getattachment/b7210a0b-aad7-4b3a-b848-bd18a5de4d14/Statuti-i-komunes-se-Ferizajt.aspx

[10] Shih intervistën e kryetarit Aliu për gazetën Koha Ditore, ku thekson se do t'i përmbush premtimet e dhëna gjatë fushatës. E disponueshme në http://www.kohaditore.com/index.php/.../repository/docs/Documents.pdf?page=1,31,101177

Grafiku 4. Realizimi i premtimeve të fushatës zgjedhore nga kryetari Agim Aliu

Projekti për funksionalizimin e bifurkacionit ka pësuar disa modifikime, i cili është përcjellë me rrënimin e një pjese të ndërtimeve dhe pastaj ridizajnimin e tij. Projekti ka filluar që të realizohet me beton dhe gurë, e më pas është rrënuar me arsyetimin se Ministria e Ambientit ka sugjeruar përdorimin e mjeteve sa më natyrale për realizimin e projektit.

Duke njohur rëndësinë jetike që ka shfrytëzimi i fondeve të Bashkimit Evropian për zhvillimin e një komune, INPO konsideron se komuna e Ferizajt me modifikimin e këtij projekti, është treguar jo serioze dhe ka dëmtuar imazhin e saj në raport me Bashkimin Evropian.

Nga ky problem, ekzekutivi ferizajas ka dështmuar se ka mungesë të kapaciteteve për shfrytëzimin e asistencës financiare të BE-së dhe mungesë të aftësive implementuese. Ato pak projekte që i ka përfituar, gjatë hartimit të tyre nuk i ka bërë analizat e duhura në terren dhe i ka propozuar komisionit evropian disa projekte që nuk kanë qenë të qartë se si do të realizohen. Kurse premtimi për ndërtimin e stadiumit nuk është realizuar akoma, premtimi i kryetarit se marrdhëniet e mira me komunitetin e biznesit do të sjellin vende të reja të punës deri më tani nuk kanë dhënë asnjë rezultat. Vlen të theksohet se komuna është duke u ballafaquar me probleme me Agjencionin Kosovar të Pronave rreth krijimit të zonave ekonomike si premtim i fushatës zgjedhore të kryetarit Aliu.

Komuna e Ferizajt është dështmuar për mungesë të vizionit dhe gjatë kësaj periudhe është qeverisur vetëm me objektiva afatshkurtëra që konsistojnë në investime kapitale infrastrukturore, ose me fjalë tjera në asfaltim të rrugëve dhe që nuk premtojn zgjidhjen e

problemeve dhe mirëqenie për qytetarin ferizajas. Këtë e dëshmon fakti se projekti më kapital i komunës është ndërtimi i bulevardit të qytetit[11], kur dihet se nevojat e qytetarëve janë të mëdha në sektorin e shkatërruar të shëndetësisë dhe për ndihma në zhvillimin e sektorit të bujqësisë.

Ekzekutivi ka dështuar që të arrijë nënshkrimin e ndonjë marrëveshje për bashkëpunim ndërkomunal ashtu siq parashihet edhe me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale.

Problemi më i madh me të cilin ballafaqohet komuna e Ferizajt është çështja e planifikimit. Kryetari Aliu gjatë këtij mandati qeverisës nuk e ka prezantuar as planin vjetor të punës apo ndonjë platform tjetër të qeverisjes, por ka vazhduar të mbështetet në ato qka ishin lënë dhe planifikuar nga pararënëdësi i tij z.Xhemaili.

Gjatë muajit nëntor të vitit 2012, INPO duke vlerësuar se komuna e Ferizajt tashmë ishte 'stabilizuar' pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme dhe duke pasur parasysh mandatin jo të plotë të kryetarit Aliu, ka kërkuar nga zyra e kryetarit qasje në planin vjetor të qeverisë komunale të Ferizajt. Mirëpo përgjigjja në kërkesën e INPO-s ishte se ekzekutivi i komunës nuk e posedon një plan të tillë dhe se mund të shtjellojmë programin e qeverisë komunale të Ferizajt.

INPO vlerëson se mungesa e planit vjetor paraqet një problem serioz, pasi që programi i qeverisë komunale të Ferizajt është pjesë e kapaciteteve humane dhe materiale që i ka lënë ish-kryetari Bajrush Xhemaili. Në këtë kontekst përfundimi i mandatit të ish-kryetarit Xhemaili dhe organizimi i zgjedhjeve të jashtëzakonshme ka rezultuar me një kryetar të ri të komunës së Ferizajt, i cili është i obliguar të hartojë platformë vjetore të qeverisjes dhe ta prezantoj atë para qytetarëve në mënyrë që të arsyetoj besimin që ka marr në zgjedhjet e jashtëzakonshme.

Plani vjetor është një hap i domosdoshëm për të konkretizuar mënyrën se si kryetari synon të punojë, objektivat e tij dhe mjetet që ka në dispozicion për ta realizuar programin që e kishte prezantuar gjatë fushatës zgjedhore, si dhe mënyrën se si do t`u përgjigjet ndryshimeve eventuale në mjedisin dinamik në të cilin vepron. INPO konsideron se qeverisja është një proces i ndërlikuar që kërkon planifikim dhe shkathtësi për të zgjedhur madje edhe afatet kohore për realizimin e projekteve, në vend të pritjes së zhvillimeve që në të shumtën e rasteve rezultojnë me vendime jo efektive.

Planifikimi vetëm do të ndikonte në avancimin e punës së ekzekutivit me qëllim që ajo të jetë sa më e organizuar dhe funksionale, ndërsa për aq kohë sa ekzekutivi nuk ka plan vjetor do të mbetet i kufizuar në të tashmen, pa orientim të mirëfilltë të detyrave administrative për projektet që do të implementohen në të ardhmen dhe pa vlerësimin dhe zhvillimin e nevojshëm

[11] Komuna e Ferizajt nënshkruan kontratë në vlerë afro 1.4 milion euro për ndërtimin e bulevardit të qytetit, për më tepër shih http://kk.rks-gov.net/ferizaj/Neës/Nise-projekti-me-kapital-i-komunes.aspx

të burimeve njerëzore në përputhje me objektivat afatgjatë që komuna e Ferizajt synon të arrijë.

Gjithashtu INPO duke parë si shqetësuese nivelin e ulët të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe duke marrë shkas nga dështimet e disa dëgjimeve publike të organizuara nga komuna e Ferizajt, pikërisht nga mos pjesëmarrja e qytetarëve, ka kërkuar nga komuna që t'i ofroj qasje në Planin e Transparencës. Përgjigjia e komunës së Ferizajt ka qenë se nuk e posedojnë një plan të tillë dhe se INPO mund ta shqyrtojë rregulloren për transparencë të miratuar në Kuvendin Komunal.

Komuna e Ferizajt duke mos e hartuar planin e transparencës nuk e ka respektuar Udhëzimin Administrativ Nr.2008/09 për Transparencën në Komuna.[12] Prandaj i INPO i përkujton komunës së Ferizajt se rregullorja për transparencë e cila rrjedh nga Ligji për Vetëqeverisjen lokale(Neni 68) vetëm e rregullon pjesëmarrjen e publikut në mbledhjet e kuvendit të komunës dhe komiteteve të tij dhe i përcakton obligimet e komunës për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe ofrimin e qasjes në dokumentet publike. Kurse, Plani i Veprimit për Transparencë është një dokument krejtësisht tjetër, të cilin komunat obligohen që ta hartojnë në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.2008/09 të MAPL-së.

Përfundimisht duke pasur parasysh mungesën e disa prej dokumenteve bazike, si strategjia për zhvillim ekonomik lokal, plani vjetor i qeverisë komunale dhe plani i transparencës, mund të konkludojmë se gjatë kësaj periudhe të raportimit qeverisja e kryetarit Aliu nuk i ka realizuar premtimet elektorale, nuk i ka përmbushur shumë obligime që dalin nga legjislacioni në fuqi dhe është kufizuar në shpërndarjen e informatave që ofrojn vetëm aspekte pozitive të komunës, dhe si e till ka qenë pjesërisht e suksesshme.

[12] Udhëzimi Administrativ Nr.2008/09 për Transparencën në Komuna, i disponueshëm në http://mapl.rks-gov.net/Main-menu/Legjislacioni/Udhezimet-Administrative/2012.aspx (Qasur në qershor 2013)

DREJTORITË KOMUNALE

Në buxhetin e vitit 2013 të komunës së Ferizajt theksohet se kryetari i komunës së bashku me stafin e tij, gjatë procesit të hartimit të buxhetit të komunës ka organizuar dy dëgjime buxhetore me qytetarët me të cilët ka komunikuar për identifikimin e nevojave dhe problemeve të tyre në mënyrë që lista për investime kapitale të hartohet në përputhje me nevojat dhe problemet e qytetarëve.[13]

Kjo mënyrë e të hartuarit të buxhetit të një komune do të ishte ideale nëse do të ishte zbatuar përnjëmend në komunën e Ferizajt. Mirëpo, INPO si monitoruese e aktiviteteve të ekzekutivit ka vërejtur se dëgjimet publike të organizuara nga kryetari kanë dështuar, pikërisht nga mos-ardhja e qytetarëve.

Gjatë muajit maj të vitit 2013 kryetari Aliu ka bërë disa emërime në ekzekutivin komunal të Ferizajt, ku kishte theksuar se ndryshimet janë bërë në bazë të energjive të reja që posedojnë personat e emëruar, me shpresë se do të rritet kualiteti i punës në këto drejtori. Mirëpo, mbetet e paqartë se për çfar energji të reja ka menduar kryetari kur janë bërë vetëm disa rotacione të drejtorëvë komunal, konkretisht Drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale z.Bashkim Hyseni është emëruar në krye të qendrës së kompetencës dhe vendin e tij e ka zënë z.Vesel Zhinipotoku, kurse koncepti i energjive të reja mund të vlejë për z.Selim Marevci, të cilit i është besuar drejtimi i Administratës, si sektor i cili përballet me mjaftë probleme.

Në mbledhjen e parë të rregullt të kuvendit komunal për vitin 2013, përmes një propozim-vendimi ekzekutivi kishte propozuar që të bëhet ndarja e re e drejtorive komunale. Ky ndryshim në strukturën e ekzekutivit do të bëhet me prpozimin për ndryshimin e statutit të komunës. Konkretisht do të ndahet Drejtoria e Financave nga ajo e Ekonomisë, Xheodezia do të jetë drejtori në vehte, ashtu edhe drejtoria e kadastrit dhe se do të shuhet drejtoria e Inspektoratit.

Në vazhdim mund të shohim në Grafikonin 2, shpërndarjen e buxhetit të planifikuar të komunës së Ferizajt për vitin 2013, nëpër kategori buxhetore.

[13] Buxheti i komunës së Ferizajt për vitin 2013, fq.20 i disponueshëm në http://kk.rks-gov.net/ferizaj/getattachment/cb0bcaa6-0d90-4ff5-b59f-309bf983bda9/Buxheti-2013.aspx (Qasur në Qershor 2013)

Grafiku 5. Shpërndarja e planifikuar e buxhetit per vitin 2013 nëpër kategori buxhetore.

Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit

Kjo drejtori nuk e ka marrë asnjëher mundimin që planifikimin dhe shpenzimin e buxhetit të komunës së Ferizajt ta paraqes në mënyrë më të detajuar, por është mjaftuar çdo herë me paraqitjen e ndarjes së buxhetit vetëm nëpër kategori buxhetore, duke e lënë të paqartë për qytetarët mënyrën se si shpenzohet buxheti brenda një kategorie të caktur. INPO vlerëson se gjatë kësaj periudhe puna e kësaj drejtorie nuk ka qenë transparente, ngase qytetarët nuk janë njoftuar asnjëher se si po shpenzohen taksat e tyre.

Drejtoria e ekonomisë ka dështuar që t'i ushtroj përgjegjësitë e veta në përputhje me ligjin për menaxhimin e financave publike dhe financat e pushtetit lokal, për faktin se nuk ka qenë në gjendje që të krijoj bazë ligjore për realizimin e buxhetit të planifikuar për vitin 2012 ngase nga 241 kontrata të prezantuara në Planin e punës për vitin fiskal 2012, prej tyre e kanë tejkaluar buxhetin e planifikuar rreth 40 kontrata.

Më tutje në planin e punës për vitin 2012 ka projekte që e kanë tejkaluar vlerën e parashikuar deri në 300% , që do të thotë se drejtoria ka lejuar që buxheti i vitit 2012 i paraparë për një numër projektesh të ekzekutohet pa bazë ligjore, ngase kompetenca për rritjen e vlerës së projekteve të parapara me planin e punës për vitin 2012 i ka takuar kuvendit komunal.

Gjatë debatit të organizuar nga INPO-ja, drejtori i ekonomisë dhe financave z.Mustafë Grainca e ka pranuar se komuna e Ferizajt ka nënshkruar kontrata pa zotim të mjeteve dhe se ka bërë shkelje procedurale, por kjo është imponuar nga Ligji për Prokurim Publik.

Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Rindërtimit

Planifikimi është një prej fushave më të ndieshme në komunën e Ferizajt. Ekzekutivi ferizajas shquhet për veprime ad-hoc, të pa bazuara në dokumente strategjike dhe të pa koordinuara me objektivat për zhvillim ekonomik. Një numër i madh i projekteve kapitale nuk përfundojnë asnjëher pa intervenuar dy deri në tri herë nga kompanitë përfituese të tenderëve, kurse edhe numri i projekteve që e tejkalojn vlerën e planifikuar është mjaftë i madh, që lë të kuptohet se planifikimi në komunën e Ferizajt nuk është në nivel të duhur dhe ballafaqohet me shumë mangësi.

Prej strategjisë për zhvillim ekonomik e hartuar gjatë vitit 2007[14], komuna e Ferizajt ka vazhduar të qeveriset duke u mbështetur në kornizat afatmesme buxhetore dhe pa dokumente strategjike. INPO-ja e ka parë shumë shqetësuese faktin se komuna mbështetet vetëm në kornizën afatmesme buxhetore 2014-2016 përball shumë sfidave për zhvillim ekonomik dhe mirëqenie.

Prandaj, INPO kërkon nga drejtoria për planifikim që të gjitha kapacitetet e veta t'i përqendroj në hartimin e dokumenteve strategjke për zhvillim të qendrueshëm ekonomik e që i mungojnë aq shumë komunës së Ferizajt. Kërkesa mbështetet në faktin se linjat për investime kapitale që mbeten si mundësia më e mirë për krijimin e një ambienti të favorshëm për zhvillim ekonomik, të parapara me kornizën afatmesme nga viti në vit pësojnë ridestinime ad-hoc që përcillen me ndryshime drastike.

[14] Strategjia për zhvillim ekonomik lokal e hartuar në vitin 2007 është e vetmja startegji e disponueshme në ëeb-faqen e komunës së Ferizajt. Strategjinë mund ta gjeni në http://kk.rks-gov.net/ferizaj/getattachment/f0527d67-1209-4d22-9701-cb3faab9fd47/Strategjia-e-Zhvillimit-Ekonomik-Lokal.aspx

Si rast për ilustrim, në kornizën afatmesme 2012-2014, për vitin fiskal 2013 janë propozuar gjashtë projekte për sektorin e rinisë në vlerë prej 579 mijë euro, kurse në buxhetin e vitit 2013 në këtë sektor parashikohen vetëm dy projekte në vlerë prej 180 mijë euro.[15] Ky është vetëm një argument se nuk mund të shpresojm për zhvillim brenda një komune përderi sa mbështetemi vetëm në kornizën afatmesme buxhetore.

Gjithashtu drejtoria nuk ka qenë e suksesshme në krijimin e kushteve të favorshme për zhvillim ekonomik të komunës që do të ndimonte edhe zbutjen e papunësisë . Për më tepër drejtoria e planifikimit nuk ka qenë shumë aktive në identifikimin e mundësive për krijimin e partneriteteve publiko-private dhe nuk ka ndërmarr ndonjë hulumtim që do t'i promovonte resurset zhvillimore të komunës që do të mund të preznatohej në formën e ndonjë panairi dhe do të krijonte parakushte për investime nga komuniteti i biznesit.

Drejtoria e Arsimit

Puna e kësaj drejtorie gjatë këtij gjashtëmujori nuk ka qenë transparente. Gjatë procesit të zgjedhjes së Drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme në Ferizaj, kjo Drejtori nuk është treguar e gatshme që zgjedhja e Drejtorëve të bëhet përmes një procesi transparent. Drejtoria nuk ka lejuar që monitoruesit e INPO-s të marrin pjesë në punimet e komisionit vlerësues për përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave dhe të shohin nga afër plotësimin e formularëve nga komisioni dhe zhvillimin e intervistave. I tërë procesi është zhvilluar prapa dyerve të mbyllura për publikun duke krijuar mjaftë hapsirë për interpretime.

Një çështje tjetër e ngritur nga INPO ka qenë edhe ndarja e bursave për studentë për vitin akademik 2012- 2013, ku drejtoria e Arsimit duke shfrytëzuar vakumin ligjor nuk ka hezituar dhe është treguar dorë shlirë me paratë publike dhe ka shpërblyer me bursa edhe studentët e kolegjeve private.

Për ta realizuar me sukses këtë veprim, Drejtoria Komunale e Arsimit në Ferizaj për dallim nga komunat e tjera të Kosovës është treguar e kujdesshme dhe ka shfrytëzuar mangësitë e rregullores për ndarjen e bursave për student[16] që nuk i definon kushtet që duhet të plotësojnë studentët për aplikim, konkretisht nuk është specifikuar nëse studentët që aplikojnë për bursë duhet të jenë student të Universitetit Publik apo edhe nga Kolegjet private.

[15] Shih Kornizën Afatmesme Buxhetore 2012-2014, e disponueshme në http://kk.rks-gov.net/ferizaj/Reguloret-dhe-Pasqyrat-Komunale.aspx

[16] Shih Rregulloren e komunës së Ferizajt për ndarjen e bursave për student, e disponueshme në http://kk.rks-gov.net/ferizaj/getattachment/92a7ab93-9596-400f-9d68-058f9e3dc72f/Rregullorja-per-ndarjen-e-bursave-per-studente.aspx (Qasur në Qershor 2013)

Nga analiza e përfituesve të bursave për vitin akademik 2012-2013 del se ndër përfituesit e bursave renditen edhe studentët e kolegjeve private siq janë: drejtimet Sociologji me ndryshime sociale dhe Mirëqenia e fëmijëve, që sipas Drejtorisë së Arsimit dhe vlerësimit të komisionit, janë futur në llogarinë e drejtimeve 'deficitare'. INPO konsideron se ndarja e bursave për studentët e kolegjeve private nuk është e drejtë dhe e zbehë edhe vet qëllimin e ndarjes së këtyre bursave që konsiderohen si një lloj ndihme ndaj studentëve.

INPO-ja ka kërkuar nga kryesuesi i kuvendit komunal që të fus në rend të ditës për mbledhjen e kuvendit komunal ndryshimin-plotësimin i nenit 6 të rregullores për ndarjen e bursave për student me një pikë të re ku përcaktohet se përfitues të bursave mund të jenë vetëm studentët e Universiteteve Publike. Mirëpo edhe pas 2 mujave që kur është bërë kërkesa INPO akoma nuk ka pranuar një përgjigjie, qoftë ajo edhe negative.

Një problem mjaftë shqetësues ka qenë edhe kthimi i raportit të përgaditur nga Drejtoria e Arsimit në mbledhjen e 21 Shkurtit 2013, ku kuvendi komunal u detyrua që për shkak të gabimeve teknike në raport vendosi që raporti t'i kthehet edhe njëher drejtorisë për përmirësim. INPO-ja vlerëson se gabimet e kësaj natyre që janë hasur tek kjo drejtori flasin për munges të kapaciteteve.

Inspeksioni

Gjatë muajit qershor të vitit 2013, INPO i ka drejtuar një kërkesën drejtorisë së Inspeksionit në Ferizaj për të na ofruar qasje në numrin e ndërtimeve pa leje dhe objekteve të padefinuara në zonat urbane 3 dhe 6 të Ferizajt.

Mirëpo kjo kërkesë e ligjshme e INPO-s, fillimisht ka hasur në pengesa administrative dhe pas tejkalimit të afatit ligjor prej 1 (një) javë[17] për t'iu përgjigjur kërkesës drejtoria ka ftuar INPO-n në zyrat e inspektoratit dhe i ka ofruar qasje e pjesshme në dokumentet e kërkuara, me arsyetimin "se nuk kemi të drejtë të ju japim kopjet e dokumenteve të kërkuara". INPO ka reaguar ndaj shkeljes së Ligjit për qasje në dokumentet publike, konkretisht të nenit 11 që thekson se ''kur lejohet qasja në dokumente publike, kërkuesi ka të drejtë të zgjedhë nëse do të

[17] Shih nenin 7 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike që thotë se Institucioni publik obligohet që brenda shtatë (7) ditëve, prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerr vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të japë përgjigjie me shkrim për të arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesërishëm dhe informon kërkuesin për të drejtën që ai ka për parashtrimin e një kërkese për rishqyrtim. Refuzimi i kërkesës bëhet me aktvendim me shkrim për refuzimin e saj. Ligji i plotë i disponueshëm në http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-215-alb.pdf (Qasur në Qershor 2013)

kontrolloj origjinalin apo kopjen, ose për të pranuar një kopje të dokumentit në çfardo forme apo formati në dispozicion sipas zgjedhjes së tij''.

Gjatë takimeve të realizuara për dokumentacionet në fjalë, INPO ka vërejtur edhe mungesën e organizimit të brendshëm të sektorit të Inspeksionit. ***Në arkivat e Inspeksionit nuk gjendeshin as zonat e ndara, konkretisht zona 3 dhe 6. Drejtori z.David Dema nga shumë takime të realizuara nuk shprehu as gadishmërin për të qenë llogaridhënës dhe tregoi munges të vullnetit për të bashkëpunuar, duke thënë se nuk i nevojiten inspeksionit numri i ndërtimeve pa leje me arsyetimin se Inspeksioni në Ferizaj nuk ka kapacitete për t'i vlerësuar jo-ligjshmërin e atyre ndërtimeve.***

INPO konsideron se sjelljet e kësaj natyre nga drejtori i Inspeksionit flasin për nivelin e ulët të transparencës brenda komunës dhe nxjerrin në pah mangësit që ka Inspeksioni, kur dihet roli i tij i rëndësishëm në inspektimin e sferës së ndërtimtarisë dhe sferave të tjera të rëndësishme.

INPO ka kërkuar nga kryetari i komunës si dhe drejtoria e Inspeksionit që t'i përmbushin obligimet ligjore, dhe në rast se nuk dëshirojn që të ofrojn qasje në dokumentet e përmendura ashtu siq përcaktohet me ligj, atëhere drejtoria e Inspeksionit duhet të përgadis një aktvendim ku sqarojn arsyet e mos-dhënies së dokumenteve të kërkuara. Në të kundërtën INPO do të kërkojë nga organet më të larta ushtrimin e kompetencave në raport me shkeljet e lartëpërmendura nga komuna e Ferizajt.

Drejtoria e Administratës dhe Personelit

Drejtoria e Administratës gjatë këtij gjashtëmujori është shquar për mos-përmbushje të misionit të saj dhe mos-repsktim të proceduarave ligjore për procedimin e çështjeve të ndryshme për votim në kuvendin komunal.

Një çështje shumë e rëndësishme e cila i shkeli të gjitha parimet demokratike të qeverisjes së një institucioni publik, ishte mos-procedimi i peticionit të fshatit Prelez nga ana administratës së kuvendit komunal. Administrata komunale bëri shkelje të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të statutit të komunës duke mos e shqyrtuar peticionin dhe duke mos e kaluar as për diskutim në KPF që pastaj të mund të procedohej si pikë e rendit të ditës dhe të debatohej në mbledhjen e kuvendit komunal.

Gjithashtu në mbledhjen e kuvendit komunal në qershor të vitit 2013, Drejtoria e Administratës nuk e procedoi për votim në kuvend draft-statutin e komunës të cilin e kishte përgaditur komisioni për hartimin e akteve nënligjore dhe e kishte vënë për diskutim publik. Në seancën e kuvendit drejtoria e Administratës kishte proceduar kundërligjshëm një version tjetër të Statutit

të komunës, që fatmirësisht hasi në rezistencë të këshilltarëve komunal dhe u pengua miratimi i tij.

Këto veprime që hyjnë në përgjegjësin e drejtorisë së administratës INPO-ja i sheh si veprime të rrezikshme dhe kërcënim për funksionimin demokratik të komunës së Ferizajt.

ZYRA E PROKURIMIT

INPO gjatë kësaj periudhe të raportimit ka monitoruar në mënyrë të rregulltë edhe zhvillimet në zyrën e prokurimit në komunën e Ferizajt. INPO e ka parë si shqetësuese shkarkimin nga pozita e shefit të prokurimit z.Abdurrahman Uruqin dhe emërimin e tij në një pozitë tjetër administrative brenda komunës së Ferizajt. Edhe pse pozita e shefit të prokurimit hyn në kuadër të pozitave me emërim nga kryetari, shkarkimi i pa pritur dhe pa ndonjë arsyetim të mirëfilltë krijon hapsirë për interpretim dhe dyshime për ecurinë e procedurave të prokurimit në komunën e Ferizajt.

INPO ka bërë përpjekje që të monitoroj të gjitha fazat e prokurimit, që nga hapja e tenderëve, vlerësimi e deri tek nënshkrimi i kontratës. Mirëpo zyra e prokurimit në Ferizaj nuk ka qenë e gatshme që ta pranoj prezencën e INPO-s në të gjitha fazat e prokurimit me arsyetimin se një gjë të till nuk e lejon Ligji për Prokurimin Publik.

Gjithashtu, INPO në kuadër të angazhimeve për promovimin e integritetit dhe transparencës në fushën e prokurimit publik, ka kërkuar nga zyra e prokurimit qasje në planin e prokurimit. Përsëri përgjigjia ka qenë negative dhe arsyetimi tashmë i njohur se një gjë të till nuk e lejon ligji. Ndërsa, vlen të përmendet se komuna e Hanit të Elezit në vazhdimësinë e aplikimit të një qeverisjeje transparente, e kishte publikuar planin e prokurimit në ëeb-faqen e komunës.

Megjithatë, INPO ka vazhduar me përpjekjet e saj dhe është duke diskutuar me zyrën e prokurimit në Ferizaj që të mundësohet pjesëmarrja e INPO-s në të gjitha fazat e tenderimit, në mënyrë që të sigurohet një proces i prokurimit sa më transparent.

INPO ka monitoruar në vazhdimësi zbatimin e kontratave të dhëna nga komuna e Ferizajt për operator të ndryshëm dhe ka vërejtur se implementimi i projekteve në terren ka hasur në probleme të ndryshme. Gjithashtu një problem i dukshëm ka qenë edhe koha e fillimit të implementimit të projekteve infrastrukturore. Shumica e projekteve kanë filluar që të implementohen pikërisht afër periudhës së zgjedhjeve lokale, dhe kjo mund të ketë pasoja negative edhe në menaxhimin e parasë publike, për arsye se shumica e projekteve të filluara gjatë fundit të vitit përcillen me vonesa në implementim në pamundësi të përfundimit të tyre për shkak të sezonës së dimrit.

Kjo traditë e implementimit të projekteve para fillimit të fushatës zgjedhore është reflektuar drejtëpërdrejtë në shpenzimin e buxhetit të komunës, ku për shumë investime të mëdha të papërfunduara në kohë bëhet i pa evitueshëm edhe një investim tjetër për ta vazhduar punën e lënë përgjysmë dhe të papërfunduar mirë. Kjo mënyrë e të qeverisurit e ka shtyer komunën e Ferizajt që të kryej edhe shkelje ligjore dhe bëjë edhe tejkalime buxhetore në raport me buxhetin e planifikuar për një vit fiskal.

VI. ADMINISTRATA KOMUNALE

Një çështje mjaftë problematike e adresuar disa herë nga INPO mbetet stër-ngarkimi i administratës komunale me të punësuar, dhe në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.Në bazë të vendimit 10/46 të qeverisë së Kosovës, në komunat e Republikës së Kosovës që kanë mbi 100 mijë banorë, një nëpunës duhet të jetë në dispozicion të 620 banorëve. Në bazë të të dhënave nga Agjencia e statistikave të Kosovës gjatë periudhës së vlerësimit deri në dhjetor të vitit 2011, komuna e Ferizajt numëron gjithsej 109.899 banorë.[18] Sipas kriterit të vendimit të qeverisë, kufiri i numrit të të punësuarve në administratën e komunës së Ferizajt është rreth 180, ndërsa aktualisht administrata komunale e Ferizajt numëron mbi 300 të punësuar.

Sipas kësaj del se buxheti i komunës së Ferizajt shpenzohet për 115 të punësuar më tepër, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në menaxhimin e buxhetit dhe duke i kontribuuar mosrespektimit të kërkesave të Fondit Monetar Ndërkombëtar për zvogëlimin e numrit të të punësuarve në administratën shtetërore dhe Bashkimit Evropian për administratë profesionale, duke vënë edhe një herë në pikëpyetje përkushtimin e kryetarit për Ferizajn Evropian.

Problem tjetër mjaftë i rëndësishëm mbetet fakti që administrata komunale e Ferizajt është nën ndikimin e politikës dhe nepotizmit. Komuna e Ferizajt ka treguar se është e aftë që të shpall konkurse aq të sofistikuara për punësim të stafit në administratë, ku përveq kritereve shumë specifike për pozita të caktuara, vetëm sa nuk mungon edhe emri i personit që do të pranohohet në punë.[19] INPO ka shprehur disa herë shqetësimin se administrata komunale po shfrytëzohet për rehabilitimin e militantëve partiak duke anashkaluar edhe parimin e konkursit te lirë dhe të pa-anshëm dhe integritetin e funksionimit të institucioneve publike.

[18] Agjencia e Statistikave të Kosovës(2013): Vlerësim-Popullësia e Kosovës 2012. Prishtinë. Marrë nga http://esk.rks-gov.net/images/files/Vleresimi%20i%20popullsise%202012.pdf

[19] Për më tepër rreth funskionimit të administratës komunale të Ferizajt shih komunikatën e përgaditur nga INPO, pas debatit me zyrtarët komunal të Ferizajt dhe anëtarë të kuvendit komunal, e disponueshme në http://inpo-ks.org/sq/aktivitetet/post/debati_administrat_komunale_ne_ferizaj

INPO ka rekomanduar komunën e Ferizajt që sa më parë të bëjë një studim të brendshëm të qëndrueshmërisë dhe kapaciteteve që i ka, në mënyrë që t'i ketë të qarta përparësit dhe mangësitë, stafin e nevojshëm dhe fushat që duhen reformuar. Është kruciale që studimi i kapaciteteve të përcillet me hartimin e një platformë për aplikimin e reformës së administratës komunale e cila duhet të filloj së implementuari gradualisht, në mënyrë që të mund të analizohen zhvillimet që dalin nga platforma dhe ndikimi i tyre në efikasitetin e punës së administratës.

Ky hap do t'i ndihmonte komunës që të kryej një reform të suksesshme të administratës, progresi i së cilës do të mund të vlerësohej kohë pas kohe në saje të indikatorëve të përcaktuar me platformën për reformimin e administratës. Gjatë tërë këtij procesi të reformimit të administratës është shumë me rëndësi që pozita e gruas të jetë e njëjtë më atë të gjinisë mashkullore, që do të rezultonte me krjimin e një administrate profesionale që funksionon duke pasur parasysh përgaditjen profesionale e jo gjininë dhe përkatësin partiake.

Administrata komunale efikase dhe e mirëfilltë çdoherë i trajton qëndrimet e qytetarëve si pikënisje e planifikimit të punës së saj dhe vendimeve që i merr. Informimi i pa mjaftueshëm dhe humbja e interesit për qëndrimet e qytetarëve nga administratat komunale e Ferizajt është një problem të cilin INPO e ka vërejtur se në mënyrë të pavitueshme po rezulton me largimin dhe hezitimin e qytetarëve për të komunikuar me administratën komunale. Në këtë mënyrë administratat komunale e Ferizajt nuk mund t'i ofrojë shërbime publike cilësore qytetarëve .

Prandaj, marrja e informatave kthyese nga qytetarët dhe veprimi në bazë të tyre duhet të jetë preokupimi kryesor për drejtuesit e administratës së Ferizajt, nëse synojn që të krijojn administratë komunale profesionale Ngase marrja e mendimeve kthyese nga qytetarët për punën e administratës nuk është koncept utopik dhe as procedurë ''bashkëkohore'' por është nevojë reale dhe mjet tejet i rëndësishëm për udhëheqjen e administratës lokale.[20]

[20] Këto ishin përfundimet nga projekti i USAID-it për Vetëqeverisje Lokale në Maqedoni me titull : *Doracak për marrjen e medimeve kthyese nga qytetarët*. Doracaku për pyetjet e administrates lokale është i disponueshëm në këtë link:
http://www.mlga.com.mk/Publications/Doracak%20per%20marrjen%20e%20mendimeve%20kthyese%20nga%20qytetaret.pdf (Qasur në maj 2012)

VII. RESPEKTIMI I PARIMEVE TË QEVERISJES SË MIRË

Elementet më të rëndësishme të transparencës përfshijnë: takime të hapura me qytetarë, paraqitje financiare, ofrimi i qasjes në dokumente publike, prokurim i drejtë, publikim i të hyrave të Kryetarit, drejtorëve, kryesuesit të kuvendit dhe anëtarëve të kuvendit, punësim i personelit në mënyrë të ligjshme dhe të hapur etj. Për më tepër, si masa plotësuese për transparencën llogariten edhe integriteti dhe etika publike, masat kundër korrupsionit dhe luftimi i konfliktit të interesit.[21]

Njëri nga premtimet e kryetarit Aliu ka qenë edhe qeverisja transparente. Vlen të theksohet se z.Aliu nga momenti që është zgjedhur kryetar i Ferizajt është treguar i gatshëm për të komunikuar me qytetarët, mediat dhe i është përgjigjur ftesave të INPO-s për takime dhe debate të ndryshme.

INPO duke pasur parasysh aktivitetin e komunës së Ferizajt gjatë kësaj periudhe kohore konstaton se komuna e Ferizajt të vetmin progres të dukshëm nga ardhja e kryetarit Aliu e ka shënuar sa i përket llogaridhënies administrative.[22] Zyrtarët e administratës komunale kanë treguar integritet dhe në përgjithësi kanë aplikuar një qasje më kooperuese me INPO-n. Komunikimi me zyrtarët komunal është ngritur në një nivel më të lartë krahasuar me qeverisjen e z.Xhemailit.

Mirëpo është vërejtur se gadishmëria e kryetarit për të marrë pjesë në debatet e organizuara nga INPO muajve të fundit ka shënuar rënie. Më konkretisht, kryetari Aliu ka filluar t'i shmanget ftesave për pjesëmarrje në debatet që janë organizuar nga INPO mbi veprimtarin e komunës.

Madje kryetari Aliu pa ndonjë arsyetim ka refuzuar ftesën e INPO-s për të marrë pjesë në takimin regjional me kryetarët e komunave, ku ishte i ftuar edhe përfaqësuesi special i Bashkimit Evropian në Kosovë z.Samuel Zbogar.[23] Në këtë takim u diskutua për mundësitë e bashkëpunimit ndër-komunal, ndërsa kryetari Aliu nuk kishte dërguar asnjë përfaqësues nga komuna e Ferizajt, duke krijuar përshtypjen se komuna që ai drejton nuk është aq e interesuar për bashkëpunim ndër-komunal.

[21] Principles of Good governance http://www.cipfa.org.uk/pt/download/governance_standard.pdf (Qasur në Maj 2013)

[22] Llogaridhënia administrative nënkupton se zyrtarët komunal duhet t'i zbatojn obligimet dhe procedurat ligjore, të jenë përgjegjshëm, të hapur dhe komunikues me qytetarët dhe shoqërinë civile.

[23] Për më tepër rreth debatit të organizuar nga INPO me temë: Shërbimet e Përbashkëta Administrative dhe Reduktimi i Kostos Administrative në komunat Jug-Lindore të Kosovës, shih komunikatën e INPO-s e disponueshme http://inpo-ks.org/sq/aktivitetet/post/sherbimet_e_perbashketa_dhe_reduktimi_i_kostos_administrative_ne_komunat_ju

INPO ka vërejtur se angazhimi i kryetarit për të qenë i hapur ndaj qytetarëve në marrjen e vendimeve dhe përfshirjen e tyre në vendimmarrje ka qenë vetëm angazhim sipërfaqësor. Aliu transparencën e ka shpërfaqur kryesisht nëpërmjet formës mediale, duke vizituar puntorët shëndetësor, bizneset dhe sportistët, por duke përjashtuar rolin e qytetarëve nga procesi i politikbërjes.

Transparenca nënkupton edhe paraqitjen financiare. Kryetari si palë raportuese i përcaktuar edhe me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale(Neni 58 pika j), nuk ka prezantuar raport 9 mujor para kuvendit komunal për situatën ekonomike-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës. Vlen të theksohet se në mbledhjen e rregullt të KK mbajtur më 29 Maj 2013, ku u diskutua edhe për ecurinë financiare të komunës për periudhën kohore Janar-Mars 2013, kryetari Aliu nuk morri pjesë.

INPO-ja mos-prezencën e kryetarit Aliu në mbledhjen ku është diskutuar për gjendjen financiare të komunës e konsideron si mos-respektim të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, që e përcakton kryetarin si palë raportuese në KK për ecurinë financiare të komunës.

Kryetari nuk i ka respektuar edhe disa elemente të tjera të rëndësishme të transparencës, siq janë: publikimi i të hyrave të kryetarit dhe punësimi i personelit në mënyrë të hapur dhe të ligjshme. INPO ka hulumtuar regjistrat për deklarimin e pasurisë në Agjencionin kundër korrupsionit dhe ka gjetur se në të dhënat për zyrtar publik të dorëzuara më 18 Mars 2013, z.Agim Aliu figuron akoma si kryesues i kuvendit komunal të Ferizajt.[24] Gjithashtu një problem tjetër që ka vërejtur INPO lidhur me transparencën në komunën e Ferizajt kanë qenë konkurset e sofistikuara për punësim në administratë dhe pranimin e personelit në baza partiake në kopshtin e fëmijëve në lagjen e re.

Gjatë këtij gjashtë mujori disa nga kërkesat e INPO-s nuk janë marrë parasysh, janë refuzuar pa arsye nga komuna duke kryer edhe shkelje të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike[25] kurse edhe ato pak kërkesa në të cilat komuna është përgjigjur, kanë qenë të natyrës përshkruese dhe nuk e kanë ofruar informacionin e kërkuar. Për periudhën e raportimit INPO ka dorëzuar gjithësej 26 kërkesa në komunën e Ferizajt, prej tyre 23 kërkesa kanë qenë për qasje në dokumente publike, kurse 1 kërkesë ka qenë për ndryshimin e rregullores për ndarjen e bursave për studentë, dhe 1 kërkesë për qasje në komisionin vlerësues të tenderëve.

[24] Shih regjistrin për deklarimin e pasurisë për vitin 2013 të përgaditur nga Agjencia kundër Korrupsionit, i disponueshëm në http://akk-ks.org/2013/Komunat/Komuna_e_Ferizajit/Agim_Aliu.pdf (Qasur në Korrik 2013)
[25] Shih më lartë problemet e ngritura nga INPO për Drejtorin e Inspeksionit dhe kërkesat drejtuar kryetarit të komunës dhe kryesuesit të KK, që nuk janë marrë parasysh.

Prej këtyrë kërkesave për qasje në dokumente publike vlen të përmendet se Drejtoria e Inspeksionit i ka refuzuar INPO-s pa ndonjë arsyetim qasjen në numrin e ndërtimeve pa leje dhe objekteve të padefinuara në zonat urbane 3 dhe 6 të Ferizajt.

Një prej indikatorëve më të rëndësishëm të transparencës, që është Web-faqja e komunës, duket se i është dedikuar vetëm kryetarit Aliu, pasi ajo freskohet vetëm me të dhëna mbi aktivitetet e kryetarit Aliu dhe njoftimet për fillimin e investimeve kapitale. Në ëeb-faqe nuk publikohen procesverbalet e mbledhjeve të kuvendit dhe të komiteteve të tij, aty mund te gjesh vetëm disa procesverbale nga viti 2010.[26] Mos freskimi i ëeb-faqes me dokumentet e fundit të komunës e tregon edhe një herë seriozitetin dhe angazhimin e komunës së Ferizajt që të aplikoj një qeverisje transparente.

Një problem tjetër që lidhet me parimet e qeverisjes së mirë është edhe dështimi i dëgjimeve publike. Për INPO-n mbetet shqetësues fakti se qytetarët e *''bojkotuan''* debatin publik mbi ndryshimin e statutit të komunës së Ferizajt, kur dihet se qfarë rëndësie ka ndryshimi i aktit më të lartë të brendshëm me të cilin qevriset komuna.

Një çështje shumë e rëndësishme e cila i shkeli të gjitha parimet e qeverisjes së mirë, ishte mos-procedimi i peticionit të fshatit Prelez nga ana administratës së kuvendit komunal. Peticioni i nënshkruar nga rreth 500 qytetarë, që edhe nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale njihet si instrument i demokracisë së drejtëpërdrejtë administratës komunale të Ferizajt i'u duk i parëndësishëm dhe si i tillë nuk u procedua asnjëherë.

[26] Në Web-faqen e komunës gjenden vetëm disa procesverbale nga viti 2010, shih procesverbalet e publikuara në linkun http://kk.rks-gov.net/ferizaj/Municipality/Assembly/Procesverbalet.aspx (Qasur në Korrik 2013)

VIII. REKOMANDIME

INPO i rekomandon kumunës së Ferizajt që :

1. Transparenca të jetë parimi udhëheqës i ekzekutivit
2. Kryetari të hartoj planin i punës
3. Të hartohet Plani i veprimit për Transparencë
4. Të hartohet strategjia për zhvillim ekonomik lokal
5. Të funksionalizohet Web-faqja e komunës
6. Të bëhet formatizimi i Administratës komunale
7. Të ndryshohet rregullorja për ndarjen e bursave për student
8. Të informohen qytetarët për aktivitetet e komunës. Informimi i qytetarëve është hapi i parë i përfshirjes së tyre në vendimmarrje, qytetari i informuar nxitet që të bashkëpunoj me institucionet komunale, të marrë pjesë në dëgjimet publike dhe të jap ide dhe sygjerime për përmirësimin e kushteve të jetesës. [27]
9. Kryetari të emëroj një zëdhënës të ekzekutivit në mënyrë që të ngritet niveli i komunikimit të mediave,shoqërisë civile me zyrën e kryetarit dhe në të njejten kohë të fuqizohet zyra për komunikim me media dhe publik, e cila për momentin i kryen dy funksione.
10. Kryetari t'i respsektoj ligjet dhe rregulloret në fuqi, duke filluar me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin për menaxhimin e financave publike, Statutin e komunës, si dhe Udhëzimet Administrative të nxjerra nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

[27] Shih eksperimentin e Kopenhagenit, ku katër rajone që kishin marrë informata mbi decentralizimin, patën përqindje më të lartë të pjesëmarrjes së qytetarëve në referendum, në krahasim me rajonet e pa informuara. I disponueshëm në http://ëëë.crca.al/sites/default/files/publications/MANUALI%20PJESMARRJA%20NE%20VENDIM-MARRJEN%20LOKALE%202011.pdf (Qasur në Qershor 2013)

PËR INPO

INPO është themeluar në vitin 2005, duke implementuar aktivitete që kanë ndihmuar integrimin e qytetarëve në proceset sociale dhe vendimmarrëse. Pas tri vite punë efektive, duke e parë të rëndësishme profilizimin e INPO-s, kemi përcaktuar fushën e politikave publike, si qëllimin bazë të punës së organizatës.

Edhe pse në INPO, në fillim të aktivitetit të saj, shumica e stafit kanë qenë pa përvojë të mjaftueshme në menaxhim dhe fushën e politikave publike, kemi arritur të dëshmojmë përkushtim dhe seriozitet në punën tonë. Në mbështetje të konsultimeve dhe disiplinës në punë; përmes performancave artistike protestuese, debatit, fushatave të avokimit, kemi arritur të ndryshojmë strategjitë dhe rregulloret jo-funksionale të institucioneve qeveritare lokale. Më tutje, ne kemi fituar respektin dhe besimin e qytetarëve duke ndërmjetësuar dhe lehtësuar në zgjidhjen e problemeve ose konflikteve administrative me qeverinë lokale.

Përgjatë shtatë viteve të punës intensive ne kemi ndërtuar raport të shkëlqyeshëm me mediat si dhe partneritet me organizata të ndryshme, duke qenë anëtar të disa rrjeteve të rëndësishme në Kosovë. Stafi i INPO-s është rritur, duke mundësuar kështu edhe rritjen e zonave të monitorimit, në më shumë komuna të Kosovës dhe duke zgjeruar programet e veprimit. Synimi që të jemi pjesë e rrjeteve rajonale është arritur dhe INPO do të vazhdojë të përmbush këtë qëllim, gjithmonë duke ruajtur raportet e mira me partnerët aktual.

Avokimi dhe fushatat sensibilizuese në fushën e politikave publike, përbëjnë aspektin më të suksesshëm të punës së organizatës gjatë këtyre shtatë viteve. Ne synojmë të jemi një partner konstruktiv në të gjitha proceset në kuadër të fushës sonë të veprimtarisë.

INICIATIVA PËR PROGRES - INPO
RRUGA "AHMET KAÇIKU" | FERIZAJ, 70000 KOSOVË
TEL: +381 (0) 38 220 552 | +381 (0) 290 329 400
WWW.INPO-KS.ORG | E-MAIL: INFO@INPO-KS.ORG